

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Filologjik- Letërsi shqipe		
Titulli i lëndës:	Letërsi e sotme shqipe(Poezia)		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Besim Muhadri		
Detajet kontaktuese:	besimmuhadri@yahoo.com		
Përshkrimi i lëndës			
	Lënda e <i>Letërsi e sotme shqipe (poezia)</i> ka për objekt studimi poezinë e sotme shqipe që kap një periudhë të gjatë, që nga koha e pasluftës së Dytë Botërore e këtej. Bëhen përpjekje që të studiohet struktura e kësaj poezie, përkatësisht struktura e procesit të zhvillimit të saj gjatë kësaj periudhe kohore.		
Qëllimet e lëndës:			
	Nëpërmjet këtij kursi studentëve u ofrohet përgatitja profesionale në fushën e poezisë së sotme shqipe, ku studnetët do të marrin informacione mbi zhvillimet e poezisë së sotme shqipe për një periudhë mbi njëgjysëmshekullore.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	Në përfundimin e këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje: - Të ketë informacione të duhura mbi procesin letrar, përkatësisht atë poetik të poezisë shqipe prej vitit 1945 e deri më tani; - Të njohë dhe të dijë më shumë për autorët më eminentë të poezisë shqipe moderne - Të interpretojë dhe të vlerësojë vepra poetike të autorëve të kësaj periudhe letrare.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3 (135 min)	15	34
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	1 (45 min)	15	11
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	5	1	5

Detyra të shtëpisë	20 min	15	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	1	1
Projektet,prezantimet ,etj			
Totali			133,5 orë 133,5:25 = 5,34 5 ECTS

Metodologjia e mësimdhënies:	Kursi organizohet në seri ligjëratash interaktive të përcjella nga diskutimet në klasë për temat që shtjellohen gjatë ligjëratave, punime seminarike për qasjen teorike si dhe prezantime individuale dhe ekipore.
-------------------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	Testi I 20 % - Vlerësimi në pikë: Vijimi i ligjëratave 5 % - 91-100 10 (dhjetë) Punimi seminarik 15% - 81-90 9 (nëntë) Provimi përfundimtar 60% -71-80 8 (tetë) Totali: 100 % -61-70 7 (shtatë) -51-60 6 (gjashtë) Nën 50 pikë 5 (pesë)
------------------------------	--

Literatura	
Literatura bazë:	Agim Vinca. Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980), ETMM, Prishtinë 1997.
Literatura shtesë:	<i>Listoni literaturën e rekomanduar/shtesë.</i>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje – njohja me materialin
<i>Java e dytë:</i>	Letërsia e luftës antifashiste Nacionalçlirimtare (poezia e viteve të para të pasluftës së Dytë Botërore)
<i>Java e tretë:</i>	Poezia e patosit kolektiv
<i>Java e katërt:</i>	Poeti në rolin e agjitorit...
<i>Java e pestë:</i>	Në kërkim të resë- Përpyqjet poetike në gjetjen e temave të reja
<i>Java e gjashtë:</i>	Poezia e realizmit lirik
<i>Java e shtatë:</i>	Poezia e lirizmit kolektiv
<i>Java e tetë:</i>	Poezia, miti, historia
<i>Java e nëntë:</i>	Poezia e simbolit kontekstual
<i>Java e dhjetë:</i>	Poezia moderne dhe avangarde
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Poezia realiste dhe novatore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Profile dhe individualitete krijuese të poezisë së viteve 80- të shek. XX
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Profile dhe individualitete krijuese të viteve 90 të shek. XX
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Poezia e viteve të funksheullit XX, pas shembjes së diktaturës

<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Rekapitullim dhe përgatitje per testin përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; - Të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave; - Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim; <p>Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimmshënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.</p>